

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndryshim i frikshëm - Mesdheu po bëhet gjithnjë e më i ngrohtë dhe i kripur (dhe për Adriatikun situata ë shtë edhe më e rëndë)
ADRESA	https://www.syri.net/klime/917899/mesdheu-po-behet-gjithnje-e-me-i-ngrohte-dhe-i-kripur-dhe-per-adriatikun-situata-eshte-edhe-me-e-rende/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 18:40:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 18:27:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0993979d0887bfbe1cf50215d2a1feb043db26b41f9f2c87e799f1b8ba683542
TEKSTI	67e62a671702e23a8394a05cc33d8f6d8426624a3145066460e77697c6123418
PAMJA	8034d00dc180a8c72eaf6692c96afcc5032d2336a0253dac6cc706e3db5d9e4c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e7161cc049f95ec6389ae4e8582d25c406cd4f356bff2a3858d4ff3fdbadb1b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	12839dc4b023db7c55325e9d2ee92462b471b26279290faf1035fe327d267353
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e7161cc049f95ec6389ae4e8582d25c406cd4f356bff2a3858d4ff3fdbadb1b7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ENVER ROBELLI
Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës



NDRIÇIM KULLA
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane

LAJMI I FUNDIT

LVIE - Protesta sot në ditën e 112-të, Rama jep dorëheqjen!



më të lexuarat

Më shumë përbytyje, më shumë
thatësira: Cikli i ujit po bëhet gjithnjë e
më i çrregullt

Klima ndryshon edhe shampanjën:
Franca detyrohet të miratojë rritjen e
përqindjes së alkoolit, ja arsyeja



Mesdheu po bëhet gjithnjë e më i ngrohtë dhe i kripur (dhe për Adriatikut situata është edhe më e rëndë)

20:27, 19/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Që nga viti 2000, Deti Mesdhe po bëhet gjithnjë e më i ngrohtë dhe më i kripur, deri në thellësinë 4 mijë metra. Deti Adriatik rrezikon një krizë ekologjike: ujërat e thella po ngrohen gjashtë herë më shpejt, duke kërcënuar të gjithë ekosistemin detar.

Më 13 gusht, ujërat e Detit Mesdhe arritën temperaturën rekord prej 28,54°C, më e larta e regjistruar ndonjëherë që nga viti 1940. Problemi nuk është vetëm se deti ynë po ngrohet dhe po rritet kripësia e tij, por edhe fakti se këto ndryshime po ndodhin me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë.

Sipas një studimi të publikuar në revistën Geophysical Research Letters, që nga viti 2000 ujërat e Mesdheut janë ngrohur me rreth gjysmë gradë Celsius në vit, ndërsa temperatura e ujërave të thella në Adriatikut jugor është rritur gjashtë herë më shpejt.

"Për ne, aspekti alarmues është shpejtësia e këtij ndryshimi dhe thellësitë në të cilat po arrijnë këto ndryshime kaq të rëndësishme", shpjegon Elena Terzić, koordinatore e studimit.

Në ujëra gjithnjë e më problematike

Dihej tashmë se gjatë viteve të fundit 100 metrat e parë të sipërfaqes së Detit Mesdhe kanë qenë rreth 2°C më të ngrohta krahasuar me mesataren e periudhës 1950–1999. Ajo që nuk ishte analizuar më parë ishte ritmi i kësaj ngrohjeje dhe nëse ajo po prekte të gjitha zonat në të njëjtën mënyrë.

Pikërisht për këtë arsye, studiueset Elena Terzić dhe Ivica Vilibić vendosën të krahasonin kripësinë dhe temperaturat në të gjithë Mesdheun për periudhën nga viti 1950 deri në vitin 2025. Vendimi erdhi pas një analize të mëparshme që kishte

Mesdheu po bëhet gjithnjë e më i ngrohtë
dhe i kripur (dhe për Adriatikut situata
është edhe më e rëndë)

Vrima e ozonit në Antarktidë u zgjerua
mbi mesataren në fillim të shtatorit

evidentuar një rritje të pazakontë të kripësisë dhe temperaturës së ujit në Adriatik.

Ajo që del qartë nga studimi është se rritja e temperaturës dhe e kripësisë së ujit është statistikisht e dallueshme, pra nuk mund t'i atribuohet rastësisë, deri në thellësi 3.000–4.000 metra.

Problemi qëndron në faktin se uji më i ngrohtë është më i lehtë, ndërsa uji më i kripur është më i dendur. Aktualisht, në ujërat sipërfaqësore mbizotëron ndikimi i nxehtësisë, ndërsa në ujërat e thella mbizotëron kripësia.

Për sa kohë kripësia të jetë më e fortë se ngrohja, uji i dendur do të vazhdojë të zhytet, edhe pse është më i ngrohtë dhe për këtë arsye më i varfër në oksigjen. Kjo lëvizje ndihmon në përzierjen e shtresave të thella dhe në transportimin e lëndëve ushqyese.

Por nëse nxehtësia do të tejkalonte ndikimin e kripësisë, situata do të bëhej serioze. Qarkullimi i ujërave të thella do të ndryshonte, uji i ngrohtë nuk do të zhytej më dhe kjo do të ndikonte drejtpërdrejt tek jeta detare.

Sipas studimit, ky rrezik është veçanërisht i rëndësishëm për Adriatikun jugor, ku që nga viti 2000 ujërat e thella janë ngrohur me një ritëm gjashtë herë më të lartë se pjesa tjetër e Mesdheut.

Mesdheu si sinjal paralajmërues për oqeanet

Vëzhgimi i Mesdheut mund të na japë një ide paraprake për atë që mund të ndodhë me oqeanet në të ardhmen. Sipas dy studiuesve, për shkak të qarkullimit relativisht të shpejtë të ujërave dhe ndjeshmërisë së lartë ndaj faktorëve atmosferikë, Mesdheu mund të konsiderohet një tregues i hershëm i përshpejtimimit të reagimit të oqeanëve ndaj ndryshimeve klimatike.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Klima ndryshon edhe shampanjën: Franca detyrohet të miratojë rritjen e përqindjes së alkoolit, ja arsyeja



Grenlanda dhe Antarktida kanë humbur 12.5 trilionë tonë akull që nga viti 1979



Më shumë përmbytje, më shumë thatësira: Cikli i ujit po bëhet gjithnjë e më i çrregullt

TË NGJASHME



I nxehti po merr gjithnjë e më shumë jetë njerëzish në qytetet evropiane



Ngrohja globale i shtyn insektet drejt lartësive, por ajri i rrallë i vë në vështirësi



'Super El Niño' kërcënon Himalajet, 'poli i tretë' i Tokës po ngrohet më shpejt



Gushti 2026 regjistrohet si muaji më i nxehtë në histori, El Niño pritet të rrisë më tej temperaturat



Somalezët, të prekur nga uria dhe zhvendosjet për shkak të klimës, përgatiten për El Niño-n



Kur njerëzit përdornin planetët, bretkosat dhe lopët për të parashikuar motin



Alarm për motin ekstrem: El Niño 'super' sjell rrezik për nxehtësi, thatësira dhe përmbytje

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.